REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E DREJTËSISË

HERONJËT E PADUKSHËM

FANA BERDYNAJ

ZYRA RAJONALE PËR NDIHMË JURIDIKE FALAS PEJË

"Drejtësia nuk është vetëm profesion, por një obligim moral ndaj secilit njeri që ka nevojë për zë, përkrahje dhe dinjitet. Gjithmonë kam besuar se puna me ndershmëri lë gjurmë, edhe kur nuk duket."

Një grua me integritet të lartë moral dhe profesional. Vullneti dhe dëshira për drejtësi, qysh në vitet e saj të rinisë, e shtyen që të pasurohet me dije e që më pastaj të angazhohet për punë publike në të mirën e përgjithshme të vendit dhe shoqërisë. Me kontributin dhe angazhimin e dhënë, Fana Berdynaj u bë shembull i një heroine të "padukshme" nga syri i opinionit të gjerë, e cila asnjëherë nuk rreshti së kryeri detyrat dhe përgjegjësitë e saj me ndershmëri, profesionalizëm dhe etikë.

Fana Berdynaj ka përfunduar studimet e nivelit bachelor në Fakultetin Juridik të Universitetit të Prishtinës. Me dijen dhe njohuritë e marra nga ky universitet, pas plotësimit të kritereve të kërkuara, ajo kaloi provimin e Judikaturës. Për më tepër, ajo ka ndjekur një sërë trajnimesh të specializuara nga organizata prestigjioze ndërkombëtare dhe vendore në fushat e ndihmës juridike, të drejtave të njeriut, administratës publike, në gjuhën angleze dhe shqipe.

Fana ka përvojë të gjatë pune në sektorin juridik dhe arsimor, duke filluar si mësuese dhe më pas si zyrtare ligjore për ndihmë juridike falas në projekte ndërkombëtare. Prej vitit 2007, ushtron detyrën si Zyrtare Ligjore në Zyrën Rajonale për Ndihmë Juridike Falas në Pejë, ku ka qenë edhe përgjegjëse e zyrës për më shumë se një dekadë. Ajo është anëtare aktive e disa komisioneve profesionale dhe shoqatave juridike, me angazhim të vazhdueshëm në përfaqësimin dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Përkushtimi dhe eksperienca e saj shumëvjeçare e bëjnë një figurë të besueshme dhe të respektuar në fushën e drejtësisë.

Këto jo vetëm që kanë thelluar njohuritë e saj profesionale, por edhe kanë forcuar aftësitë praktike në komunikim, ndërmjetësim dhe planifikim strategjik. Sot, këto përvoja përbëjnë themelin profesional mbi të cilin ajo vazhdon të punoj me përgjegjësi dhe integritet.
Teksa po shkruajm për të nderuarën, kolegen tonë, fort të dashur lexues, shprehim falenderimet tona më të sinqerta për bashkëpunimin profesional, kolegialitetin njerëzor dhe njohjen kualitative që kemi pasur ndër vite.

Fana këtë vit do të pensionohet në aspektin formal-juridik por shpirti dhe kontributi i saj nuk do të pensionohen asnjëherë!

MBROJE TË DREJTËN TËNDE
ZAŠTITI SVOJE PRAVO